



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas parashtrësës së operatorit ekonomik "UBT" të datës 11.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË si e palejuar** parashtrësja e operatorit ekonomik "UBT" e datës 11.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 08.04.2024 për aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "UBT" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "UBT" (tutje "parashtruesi") me datë 11.04.2024 ka dorëzuar përmes emailit një parashtrësë me titull "ankesë" kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të parashtrësës është gjetur se parashtrësja nuk është dorëzuar fare përmes sistemit e-prokurimi. Po ashtu parashtrësja si e tillë nuk korrespondon fare me F02 - Formularin e Kërkesës për Rishqyrtim. Në fakt parashtrësja si e tillë nuk është fare kërkesë për rishqyrtim por është krejt tjetër juridik e cila titullohet si ankesë mirëpo nuk korrespondon as me F01 - Formularin Standard të Ankesës.

Përmes nenit 59 par 1 të RRPP është përcaktuar se “Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që pretendohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij pranë Autoritetit kontraktues i cili udhëheq aktivitetin e prokurimit. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit”.

Tutje përmes nenit 60 par 1 të RRPP është përcaktuar se “Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik”.

Përmes nenit 60 par. 3 të RRPP është përcaktuar se “Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë: a. emrin, adresën postare, adresën elektronike, dhe informatat e kontaktit të parashtruesit të ankesës; b. emrin e autoritetit kontraktues në fjalë; c. një përshkrim specifik të arsyeshem të aktivitetit të prokurimit; d. bashkëngjitur një kopje të njoftimit të kontratës në fjalë ose njoftimit të rezultatit të konkursit për projektim, nëse një e tillë është nxjerrë apo publikuar; e. Demonstron se parashtruesi i ankesës kualifikohet si një “palë e interesuar,” sikurse përkufizohet nën nenin 4 të ligjit; f. Përshkruan rrethanat faktike që përbejnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar; g. Specifikon dispozitën apo dispozitat e LPP-së që pretendohet se janë shkelur; dhe h. Përshkruan se si është shkaktuar shkelja e pretenduar, apo kërcënon të shkaktojë, dëm material parashtruesit të ankesës në rastet ku parashtruesi i ankesës përfshin një padi për kompensim”.

Parashtresa e OE “UBT” nuk është dorëzuar si kërkesë për rishqyrtim në kuptim të nenit 59 par. 1 të RRPP, nuk korrespondon me formularin F02 dhe nuk është dorëzuar përmes eprokurimit në kuptim të nenit 60 par. 1 të RRPP si dhe nuk përmban të dhënat e domosdoshme të përcaktuara sipas nenit 60 par. 3 të RRPP. Rrjedhimisht përmes nenit 62 par 1 të RRPP është përcaktuar se “Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: a) kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj rregullore. b) kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 59.1 të kësaj rregullore; c) kërkesa nuk përputhet me kërkesat e përmendura në nenin 60.1 dhe nenin 60.2 të kësaj rregullore; d) pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim janë të pabazuara”.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur në kundërshtim me nenin 59 par. 1 lidhur me nenin 60 par. 1 dhe par. 3 të RRPP. Prandaj parashtresa është hedhur poshtë si e palejuar në kuptim të nenit 62 par. 1 nënpar. a, b dhe c të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën a) lidhur me nenin 62 par. 1 nënpar. a, b dhe c të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.04.2024



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.